



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 135, Datë 21.05.2026

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 207, DATË 09.09.2025  
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “AMEL ENERGY” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË  
E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME  
KAPACITET PRODHUES 2 MW”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e Entit Rregullator të Energjisë, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.05.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 415/4 prot., datë 19.05.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 207, datë 09.09.2025 “Mbi licencimin e shoqërisë “AMEL ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet prodhues 2 MW”,

**Konstatohet se:**

**1. Të dhëna mbi shoqërinë “AMEL ENERGY” sh.p.k.**

- Bordi i ERE-s, me vendimin e nr. 207, datë 09.09.2025, vendosi të licencojë shoqërinë “AMEL ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet prodhues 2 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.
- Në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi përcaktohet se shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 31.12.2025 dhe të depozitojë në ERE testimin e veprës jo më vonë se 60 ditë nga ky fakt. Ndërsa në pikën 4 përcaktohet se ky vendim është objekt rishikimi në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve në pikat 2 dhe 3.

**2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria**

- Në kuadër të rakordimit të plotësimit të kushteve respektive të vendimit, ERE i ka rikujtuar shoqërisë detyrimin për depozitim të sa përcaktuar në këto kushte me shkresën me nr. 415 prot., datë 29.01.2026.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 415/1 prot., datë 06.02.2026, shoqëria ka bërë me dije se ka filluar ushtrimin e veprimtarisë brenda datës 31.12.2025, si dhe ka depozituar bashkëlidhur njoftimin përkatës drejtuar AKBN, për përfundimin e testimit 72-orësh; njoftimin drejtuar MIE-s dhe AKBN-së, në lidhje me përfundimin e punimeve dhe testimin e veprës, si dhe Kontratat e furnizimit dhe shit-blerjes së energjisë elektrike të nënshkruar me FTL sh.a., në datën 06.01.2026.
- Me shkresën me nr. 415/2 prot., datë 20.04.2026, ERE i ka kërkuar shoqërisë të depozitojë informacionin/dokumentacionin përkatës të testimit të veprës.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 415/3 prot., datë 27.04.2026, shoqëria ka depozituar dokumentacionin e testimit të veprës.

### **3. Analiza ligjore dhe vlerësimi**

- Rezulton se shoqëria ka filluar operimin brenda datës 31.12.2025 dhe ka dokumentuar në ERE testimin e veprës. Si e tillë, vlerësohet se ajo ka përmbushur kushtet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të vendimit nr. 207/2025, ndaj vlerësohet që këto pika të shfuqizohen.
- Në vijim të shfuqizimit të pikave 2 dhe 3 të vendimit nr. 207/2025, të ndryshuar, vlerësohet i nevojshëm edhe ndryshimi i pikës 4, si vijon: *Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.*

### **4. Nevoja për ndryshimin e vendimit**

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet nga organi kompetent.
- Në kushtet kur pikat 2 dhe 3 të vendimit nr. 207/2025, të ndryshuar, janë përmbushur, vlerësohet se duhet të shfuqizohen.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e bordit të ERE-s nr. 207, datë 09.09.2025, si vijon:
  - a) Pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 207, datë 09.09.2025, *shfuqizohet.*
  - b) Pika 3 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 207, datë 09.09.2025, *shfuqizohet.*
  - c) Pika 4 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 207, datë 09.09.2025 ndryshon dhe bëhet: *“Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.”.*
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “AMEL ENERGY” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a., shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. dhe shoqërinë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike” (ALPEX) sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**